

**FORMULARI I MIRATIMIT DHE KUSHTET E PËRDORIMIT
PËR REZIDENTËT PËR SHËRBIMET E
QENDRËS SË APLIKIMIT PËR VIZË KANADEZE (QAVK) nga VFS GLOBAL**

1. Shërbimi i QAV-së

QAVK-ja kryen një numër shërbimesh ndihmëse administrative si dhe kryen shërbimin e marrjes së të dhënave biometrike për klientët të cilët dëshirojnë të aplikojnë për të hyrë në Kanada.

Tarifat e shërbimeve të QAVK-së janë autorizuar nga Qeveria Kanadeze.

2. Përgjegjësia

VFS Global nuk është agjenci e Qeverisë Kanadeze. QAVK-ja është një njësi tërësisht e pavarur që vepron në bazë të ligjeve të vendit ku ofrohen shërbimet dhe është përgjegjëse vetëm për ofrimin e shërbimeve të saja.

3. Gjuha e shërbimit

QAVK-ja ofron shërbimin dhe mban të gjitha komunikimet e saj në gjuhën Angleze, Franceze, si edhe në gjuhën Shqipe.

4. Marrëveshje

Unë, si përdorues i shërbimeve të QAVK-së, kuptoj dhe bie dakord se:

E kam lexuar plotësisht këtë dokument. Qëllimi i përdorimit të shërbimeve të QAVK-së është të më ndihmojë për t'i paraqitur Qeverisë Kanadeze aplikimin tim dhe bazohet në kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë dokument. Unë e kuptoj që VFS Global nuk ka fuqi vendimarrëse apo ndikuese mbi aplikimin tim për vizë.

Informacioni personal merret nga QAVK nën autoritetin e një kontrate ndërmjet VFS Global Services dhe Qeverisë Kanadeze. Ky autoritet përfshin çdo nënkontraktor të miratuar. QAVK në Shqipëri, do të marrë prej meje dokumente dhe do të mbledhë informacion personal lidhur me mua vetëm për qëllime që kanë të bëjnë me shqyrtimin e aplikimit nga Qeveria Kanadeze për vizë, leje ose dokumente Kanadeze udhëtimi, përfshi transferimin e këtyre dokumenteve dhe informacioneve në Qeverinë Kanadeze dhe anasjelltas.

Më tej, nëse kërkohet në "Pranimi për dorëzimin/mbledhjen jo të drejtpërdrejtë", i jap miratimin QAVK-së, të marrë dokumentet e mia dhe informacionin personal nga personi përmendur konkretisht më poshtë.

Informacioni im personal mund të përfshijë formularin e aplikimit, dokumente mbështetëse ose të llojeve të tjera, përfshi gjurmët e gishtave, fotografitë dhe të dhëna të tjera biometrike, sipas kërkesës së Qeverisë Kanadeze. Informacioni im personal mund të përfshijë edhe të dhëna lidhur me aplikimin, identitetin, të dhënat biografike dhe të kontaktit, përfshirë informacionet elektronike apo të dhëna të tjera lidhur me aplikimin tim.

Për të marrë autorizimin e Qeverisë së Kanadasë si kontraktore, QAVK-ja do të respektojë parimet e fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, miratuar me ligje të ndryshme në Kanada. Një kopje e këtyre parimeve më është dhënë mua dhe duke nënshkruar këtë formular, konfirmoj se njoh parimet dhe informacionin mbi kontaktin ndaj Zyrës së Komisionerit të Privatësisë për Kanadanë.

Këto dokumente dhe informacioni elektronik do t'i përcillet Qeverisë Kanadeze, duke qenë kusht për ofrimin e shërbimit.

Unë kuptoj se QAVK-ja do të mbledhë, përdorë, zbulojë dhe ruajë informacionin tim personal për aplikimin tim për të hyrë në Kanada, në përputhje me kushtet e kontratës së saj me Qeverinë Kanadeze për qëllimet e ndihmës në shërbimin administrativ dhe mbledhjes së të dhënave biometrike, kur është e nevojshme. Qeveria e Kanadasë ia ka ndaluar QAVK-së të përdorë apo zbulojë informacionin tim për qëllime të tjera, përveçse kur unë kam dhënë një miratim të mëtejshëm me shkrim. Unë kuptoj se nëse kam dyshime lidhur me përdorimin e informacionit tim personal ndaj QVAK, kam të drejtën të paraqes një ankim në Zyrën e Komisionerit të Privatësisë së Kanadasë, duke përdorur informacionin e kontaktit që më është dhënë.

EMRI & MBIEMRI (me shkronja shtypi): _____

ADRESA: _____

NUMRI I TELEFONIT: _____

ADRESA ELEKTRONIKE: _____

NËNSHKRIMI: _____

DATA: _____

NËNSHKRUAR NË: _____ (qyteti, shteti)

**Miratimi për dorëzimin dhe/ose mbledhjen jo të drejtpërdrejtë të të dhënave
(për t'u plotësuar VETËM nëse përdoret agjenti i udhëtimit apo përfaqësuesi përveç
aplikuesit në vetvete për të dorëzuar dhe/ose mbledhjen e aplikimit për vizë apo
vendimmarrjen)**

Unë jap miratimin tim që QAVK-ja në _____ (Qyteti, Shteti) të mbledhë dokumentet e mia nga:

Emri Personit që dorëzon një aplikim ose mbledh vendimmarrjen në emrin tim:

Marrëdhënia me aplikuesin (nëse aplikohet): _____

Nënshkrimi i aplikuesit _____ Data _____

**Deklarata duhet të nënshkruhet VETËM nga aplikuesit e ndihmuar prej personelit të VFS
Global me formularin elektronik të aplikimit**

Unë kam marrë ndihmën e personelit të VFS Global për hedhjen e të dhënave të informacionit të aplikimit tim. Unë i kam paraqitur të gjitha informacionet dhe përgjigjet e nevojshme për aplikimin. Kam lexuar dhe plotësuar e shtypur formularin e aplikimit dhe deklaroj se informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe se dokumentet që shoqërojnë aplikimin që po dorëzoj janë origjinale dhe nuk janë ndryshuar në asnjë lloj mënyre.

Emri: _____

Firma: _____ Data: _____

Aplikantët që dëshirojnë të japin të dhënat biometrike

Unë konfirmoj që kam parë mjetin e vlefshmërisë dhe të kërkesës së të dhënave biometrike në faqen zyrtare të internetit të IRCC dhe do të jap të dhënat e mia biometrike pavarësisht informacionit të siguruar nga faqja zyrtare e IRCC.

Kam marrë këtë vendim me vullnetin tim të lirë dhe pa asnjë ndikim apo sugjerim nga stafi i QVAK.

Emër dhe mbiemër: _____

Firma: _____

Data: _____

Aplikantët që NUK dëshirojnë të japin të dhënat biometrike

Unë konfirmoj që kam parë parë mjetin e vlefshmërisë dhe të kërkesës së të dhënave biometrike në faqen zyrtare të internetit të IRCC dhe kam vendosur të mos jap të dhënat e mia biometrike.

Kam marrë këtë vendim me vullnetin tim të lirë dhe pa asnjë ndikim apo sugjerim nga stafi i QVAK.

Emër dhe mbiemër: _____

Firma: _____

Data: _____